



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 43/5 prot.

Tiranë më 29/01/2020

VENDIM

Nr. 6, datë 29.01.2020

“Për miratimin e fillimit të procedurës për akreditimin institucional të Akademisë së Studimeve Albanologjike”

Në bazë të nenit 51, pika 2, e ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 8 të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Vendimit nr. 109, datë 15.02.2017 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Në kuadër të vendimit të Senatit Akademik të ASA, miratohet fillimi i procedurës për akreditim institucional të Akademisë së Studimeve Albanologjike.
2. Miratimin e fondit prej 910.875 lekë të nevojshme për akreditimin institucional të ASA.
3. Ngarkohet Zyra e Financës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

